

# MANUAL PËR PËRDORIM TË E-BANKING PËRMES TELEFONAVE INTELIGJENTË (SMART PHONES)”

## Përmbajtja

|           |   |           |
|-----------|---|-----------|
| <b>1.</b> | <b>Qëllimi i dokumentit.....</b>                                      | <b>3</b>  |
| <b>2.</b> | <b>Informata të përgjithshme .....</b>                                | <b>3</b>  |
| 2.1       | Profilet e përdoruesit .....  | 3         |
| <b>3.</b> | <b>Udhëzimet e përdoruesit për shërbime bankare në internet .....</b> | <b>3</b>  |
| 3.1       | Urdhërpagesat përmes versionit mobil të e-Banking .....               | 4         |
| 3.2       | Përgjegjësitë e bankës dhe të klientit.....                           | 4         |
| <b>4.</b> | <b>Qasja.....</b>   | <b>5</b>  |
| 4.1       | Përmbledhja e shërbimeve.....   | 5         |
| 4.2       | Menyja "Llogaritë rrjedhëse" .....                                    | 6         |
| 4.3       | Menyja "Llogaritë e kursimit" .....                                   | 8         |
| 4.4       | Menyja "Llogaritë e kartelave" .....                                  | 9         |
| 4.5       | Menyja "Llogaritë e depozitave me afat" .....                         | 10        |
| <b>5.</b> | <b>Menyja "Transferet" .....</b>                                      | <b>12</b> |
| <b>6.</b> | <b>Menyja "Pagesa për aprovim" .....</b>                              | <b>15</b> |
| <b>7.</b> | <b>Menyja "100 urdhrat e fundit" .....</b>                            | <b>17</b> |

## 1. Qëllimi i dokumentit

Qëllimi i këtij manuali është që t'i udhëzojë shfrytëzuesit për mënyrën e përdorimit të shërbimit e-Banking përmes telefonave inteligjentë (Smart Phones). Manuali do të përcillet me dritaret (screenshot) përkatëse të cilat paraqiten gjatë punës me e-Banking përmes telefonave inteligjentë.

## 2. Informata të përgjithshme

Versioni mobil i e-Banking është shërbim i cili do t'ju mundësojë qasjen në llogaritë e juaja dhe operimin me to duke e shfrytëzuar internetin përmes telefonave inteligjentë. Ky shërbim do të jetë në dispozicion 24 orë në ditë/7 ditë në javë.

Për të përdorur këtë shërbim, mjafton që të keni qasje në internet përmes telefonisë mobile. Ju do të përfitoni nga kjo mundësi, duke mos pasur nevojë për kompjuter apo për të pritur në radhë në bankë për t'u qasur në llogari dhe për të inicuar transfere të parave.

Versioni mobil i e-Banking ju mundëson:

### a) Operimin me llogari

- Regjistrimin e transfereve brenda bankës
- Regjistrimin e transfereve nacionale (te bankat e tjera kombëtare)

### b) Informacionet mbi llogaritë

- Lëvizjet në llogari dhe bilancet e tyre
- Shikimi i urdhrave të fundit të regjistruara nga e-Banking
- Shikimi i të gjitha urdhrave të regjistruara paraprakisht përmes bankës tonë

### 2.1 Profilet e përdoruesit

Sipas sistemit bankar, përdorues në internet është çdo person fizik i cili është i autorizuar të punojë me llogaritë bankare në bankën ProCredit, të cilit i jepet një emër i veçantë i përdoruesit dhe një fjalëkalim për qasje në shërbimet bankare në internet. Ky përdorues mund të hyjë vetëm në llogaritë e tij/saj dhe ato për të cilat ai ose ajo është i/e autorizuar.

## 3. Udhëzimet e përdoruesit për shërbime bankare në internet

Qasja në sistemin bankar në internet përmes telefonisë mobile u lejonet vetëm klientëve që kanë bërë kërkesë në degët e Bankës ProCredit për shërbimin e-Banking, (kërkesa e njëjtë vlen edhe për versionin mobil të e-Banking).

Sipas standardit të kontratave, për klientët privatë ekzistojnë dy lloje të kontratave lidhur me produktin e-Banking:

- e-Banking standard - klienti është në gjendje t'i shohë të gjitha llogaritë e tij si mbajtës i llogarisë (p.sh. llogarinë rrjedhëse, llogarinë e kursimeve, planin e kursimeve, llogarinë e arkëtueshme / kredit kartën, llogarinë e depozitave me afat dhe limitin e mbitërheqjes).
- e-Banking premium - klienti është në gjendje t'i shohë të gjitha llogaritë e tij si mbajtës i llogarisë dhe llogaritë për të cilat është i autorizuar, përfshirë llogarinë ProKid. Po ashtu, klientëve që kanë kontratë Premium e-Banking u lejohet që t'i realizojnë urdhrat për pagesa nga llogaria rrjedhëse në llogarinë ProKid dhe anasjelltas.

Ndërsa, për klientët e biznesit ekzistojnë kontratat e mëposhtme:

- e-Banking Full Mode (LE) - i mundëson klientit operimin e plotë me llogaritë e biznesit në të cilat është i autorizuar.
- e-Banking Selective Mode (LE) - i mundëson klientit operimin me llogaritë e biznesit ku është i autorizuar në bashkëpunim me përdoruesin tjetër.

Për të fituar të drejtën e hyrjes, ju duhet të hapni faqen e siguruar dhe të certifikuar të ProCredit Bank Kosova në Internet <https://ebanking.procreditbank-kos.com/Mobile/User/LogOn>

### 3.1 Urdhërpagesat përmes versionit mobil të e-Banking

Banka pranon vazhdimisht urdhërpagesa të bëra përmes shërbimit elektronik bankar - njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë në javë. Urdhërpagesat të cilat nuk i posedojnë informatat e domosdoshme apo në rastet kur llogaria nuk ka mjete të mjaftueshme, nuk mund të realizohen përmes shërbimit elektronik.

Informata të përgjithshme lidhur me realizimin e urdhërpagesave përmes shërbimit elektronik bankar m-Banking:

1. Të gjitha transferet e regjistruara në intervalin kohor pas orës 20:00 do të mbesin të paekzekutuara nga banka deri në orën 05:00 të ditës së ardhshme.
2. Urdhërpagesat institucionale (brenda degëve të ProCredit Bank) mund të realizohen vetëm në valutën EURO.
3. Urdhërpagesat institucionale (brenda degëve të ProCredit Bank) të cilat realizohen në mes të llogarive me valutë të njëjtë, do të ekzekutohen nga banka prej orës 05:00 deri në orën 20:00 brenda të njëjtës ditë.
4. Urdhërpagesat kombëtare (të drejtuara te klientët e bankave të ndryshme vendore) mund të realizohen vetëm në valutën EURO.
5. Urdhërpagesat kombëtare ekzekutohen dhe dërgohen te bankat e tjera nga ora 8.30 deri në orën 15.00 (me të njëjtën datë të valutimit). Urdhërpagesat kombëtare të regjistruara pas këtij orari, do të ekzekutohen nga banka dhe do të dërgohen te bankat e tjera ditën e ardhshme të punës.


### 3.2 Përgjegjësitë e bankës dhe të klientit

1. Gjatë realizimit të një urdhërpagese nga ana e klientit, banka kujdeset për ligjshmërinë e transaksioneve;
2. Klienti është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të përfituesit, për këtë arsye ai bart të gjitha pasojat e një urdhërpagese të gabuar apo të pasaktë;
3. Nëse një urdhër është realizuar me gabime nga ana e bankës, atëherë banka është përgjegjëse;
4. Banka nuk është përgjegjëse për veprimet e paligjshme nga palët e treta, të cilat janë dëmtuese për klientin si pasojë e përdorimit të shërbimit elektronik bankar, si dhe për mosrealizimin e urdhërpagesave të klientit për shkaqe teknike jashtë kontrollit të saj;
5. Përdoruesit kanë për detyrë që ta mbajnë në një vend të sigurt ID-n e sigurisë RSA(tokenin)

6. Përdoruesit kanë për detyrë që t'i mbajnë të fshehta kodet dhe fjalëkalimet e tyre për qasje në shërbimin elektronik bankar;
7. Nuk rekomandohet që të shkruhen kodet dhe fjalëkalimet;
8. Ju rekomandojmë që të fikni çdo parametër që automatikisht ruan fjalëkalimet;
9. Ju rekomandojmë që të siguroheni se jeni qasur në m-Banking linkun e duhur i cili fillon me "https";
10. Banka nuk është përgjegjëse për zbulimin e fjalëkalimeve, kodeve të ID-s së sigurisë RSA nga palët e treta.


## 4. Qasja

Për qasje në versionin mobil të e-Banking ju duhet të shfrytëzoni emrin përdorues dhe fjalëkalimin e njëjtë me të cilin qaseni edhe në e-Banking.



Për t'u qasur, duhet që fillimisht të zgjedhni gjuhën, të shkruani emrin e përdoruesit (i zgjedhur gjatë procesit të aplikimit në degë), si dhe fjalëkalimin. Pasi të keni futur të gjithë informacionin e nevojshëm, duhet të shtypni butonin "Hyrje".

Pamja që do të shfaqet pas kësaj do të duket si më poshtë, në të cilën paraqitet "**Përmbledhja e shërbimeve**":



### 4.1 Përmbledhja e shërbimeve

Ekrani i parë që do të shihni është "**Përmbledhja e shërbimeve**" të e-Banking në M-Version. Detajet për këto shërbime do të paraqiten, varësisht prej produkteve bankare që posedoni dhe llojit të kontratës e-Banking.

Pjesa e parë e faqes "**Përmbledhja e shërbimeve**" paraqet një listë të produkteve (p.sh. llogaria rrjedhëse, llogaria e kursimit, llogaritë e kartelave të kreditit, llogaria e afatizimit) që ju posedoni në ProCredit Bank në Kosovë. Në pjesën e poshtme të saj është e paraqitur menya për: transfere, pagesat në pritje për t'u aprovuar dhe 100 urdhërpagesat e fundit.

## 4.2 Menyja "Llogaritë rrjedhëse"

Nëse shtypet mbi fushën "Llogaritë rrjedhëse":



Do të shfaqen të gjitha llogaritë rrjedhëse dhe bilancet e tyre për të cilat ju jeni llogarimbajtës apo person i autorizuar, varësisht prej kontratës.



Për të shikuar më tepër detaje rreth llogarisë, duhet të shtypni "Informacioni i llogarisë" dhe do t'ju shfaqen detajet si: produkti, valuta, balanca e vlefshme, limiti i paradhënies bankare.



Lëvizjet e llogarisë rrjedhëse mund të shihen, nëse shtypni butonin "Transaksionet e llogarisë".

ProCredit Bank e-Banking

Mirë se erdhët, Mobile Test

---

Numri i llogarisë 1110335701000126  
 Emri i llogarisë Mobile Test  
 Lloji i llogarisë Llogaria rrjedhëse  
 Numri i transaksioneve 17

---

Zgjidhni numri i ditëve  
 10 30 90

---

|            |  |                       |
|------------|--|-----------------------|
| 2012-12-12 | Card application commission payment  | <b>EUR -5,00</b>      |
|            |  | EUR 5.072,81          |
| 2012-12-11 | Ajansa eur<br>Test M., test, Ajansa eur Ajansa eur; 1140123027000170;test;Mobile Test - 1110335701000126 | <b>EUR -10.000,00</b> |
|            |  | EUR 5.077,81          |
| 2012-12-11 | Mobile Test 45444545   | <b>EUR 3.000,00</b>   |
|            |  | EUR 15.077,81         |
| 2012-12-11 | Mobile Test 45444545   | <b>EUR 4.500,00</b>   |
|            |  | EUR 12.077,81         |
| 2012-12-11 | Mobile Test 45444545   | <b>EUR 4.500,00</b>   |
|            |  | EUR 8.577,81          |



Për të shikuar më tepër detaje rreth transaksionit përkatës, duhet të shtypni shigjetën e cila i drejton në dritaren e mëposhtme:

**Detajet e transferit**

---

|                            |            |
|----------------------------|------------|
| <b>Data e regjistrimit</b> | 2012-12-12 |
| <b>Data valide</b>         | 2012-12-12 |

---

|              |                  |
|--------------|------------------|
| <b>Shuma</b> | <b>EUR -5,00</b> |
|--------------|------------------|

---

**Arsye**  
Card application commission payment

---

**Lloji i transaksionit**

---

Mbrapa

### 4.3 Menyja “Llogaritë e kursimit”

Nëse shtypni mbi fushën “Llogaritë e kursimit”:



Do të shfaqen të gjitha llogaritë e kursimit dhe bilancet e tyre për të cilat ju jeni llogarimbajtës apo person i autorizuar, varësisht prej kontratës.



Për më tepër detaje rreth llogarisë, duhet të shtypni butonin “Informacioni i llogarisë” dhe do t’ju shfaqen detajet si: produkti, valuta dhe balanca e vlefshme.







Lëvizjet e llogarisë së kursimit mund të shihen, nëse shtypni butonin “**Transaksionet e llogarisë**”, njëjtë sikur për llogaritë rrjedhëse.

#### 4.4 Menyja “Llogaritë e kartelave”


Nëse shtypni mbi fushën “**Llogaritë e kartelave**”:



Do t’ju shfaqen llogaritë e kartelave të kreditit dhe bilancet e tyre.



Për më tepër detaje rreth kartelës, duhet të shtyni butonin **“Informacioni i llogarisë”** dhe ju shfaqen detajet si: produkti, valuta, balanca e vlefshme dhe limiti i aprovuar.




Lëvizjet e llogarisë së kartelave mund të shihen, nëse shtypni butonin **“Transaksionet e llogarisë”** njëjtë sikur për llogaritë rrjedhëse.

#### 4.5 Menyja “Llogaritë e depozitave me afat”

Nëse klienti shtyp mbi fushën **“Llogaritë e depozitave afatgjatë”**



Do të shfaqen të gjitha llogaritë e depozitave afatgjatë dhe gjendjet e tyre për të cilat jeni llogarimbajtës apo person i autorizuar, varësisht prej kontratës.



ProCredit Bank e-Banking

Mirë se erdhët,

1110188909020169 TEST TESTING

Gjendja e llogarisë EUR 2.000,00

Informacioni i llogarisë

Transaksionet e llogarisë

Llogaritë rrjedhëse

Llogaritë e kursimit

Llogaritë e kartelave

Llogaritë e depozitave afatgjatë

Transferet


Pagesa për aprovim

100 urdher pagesat e fundit

Dalje

Versione desktop

Për më tepër detaje rreth llogarisë, duhet të shtypni butonin **“Informacioni i llogarisë”** dhe shfaqen detajet si: produkti, valuta dhe data e maturimit.



ProCredit Bank e-Banking

Mirë se erdhët,

1110188909020169 TEST TESTING

Gjendja e llogarisë EUR 2.000,00

Informacioni i llogarisë

Product Standard Time Deposit EUR 360

Valuta EUR

Maturity Date 2014-03-03

Transaksionet e llogarisë

Llogaritë rrjedhëse

Llogaritë e kursimit

Llogaritë e kartelave

Llogaritë e depozitave afatgjatë

Transferet


Pagesa për aprovim

100 urdher pagesat e fundit


Lëvizjet e llogarisë së depozitave me afat mund të shihen, nëse shtypni butonin **“Transaksionet e llogarisë”** njëjtë sikur për llogaritë rrjedhëse.

## 5. Menyja “Transferet”

Për të regjistruar transfere, duhet të përdorni opsionin “Transferet” nga menyja kryesore:




Pasi të keni shtypur këtë fushë, do të paraqitet dritarja e mëposhtme:




Transferet nga M-versioni mund të iniciohen vetëm te përfituesit të cilët paraprakisht janë regjistruar në “Listën e përfituesve” nga versioni e-Banking desktop.


Në listën e parë rrethqitëse të kësaj dritareje do të shfaqen llogaritë nga të cilat klienti mund të iniciojë transfere.



Ndërsa, në listën e dytë rrëshqitëse paraqiten llogaritë e regjistruara në listën e përfituesve, duke mos përfshirë përfituesit ndërkombëtarë.



Pasi të jenë zgjedhur llogaritë, duhet të shtypni mbi fushën **“Vazhdo”**.



Automatikisht hapet dritarja tjetër, në të cilën duhet të futen të dhënat si: shuma e transferit, detajet e pagesës.

Mire se erdhet, TEST TESTING

**Transferta**

logarise  
1110188909000187, TEST TESTING

Perfituesit  
1140123027000170, Filan Fisteku, Procredit Kosovo

Shume  
10.00

EUR

000 - DEFAULT OPTION

Arsyeja  
test

Vazhdo

Pasi të jenë futur këto të dhëna, shtypet fusha “Vazhdo” dhe hapet dritarja e mëposhtme:

Mire se erdhet, TEST TESTING

**National Transfer**

logarise  
1110188909000187, TEST TESTING

Perfituesit  
1140123027000170, Filan Fisteku, Procredit Kosovo

Adresa  
Prishtine

Arsye  
test

Transferit

|               |                  |
|---------------|------------------|
| Shume         | 10,00 EUR        |
| Fee           | 0,00 EUR         |
| <b>Totale</b> | <b>10,00 EUR</b> |

Token

Register

Te fusha “Token” duhet të shënohet numri i cili gjenerohet në atë moment te tokeni dhe shtypet fusha “Regjistroni”, e cila ju dërgon te dritarja me përmbledhjen e transaksionit të realizuar.

Mire se erdhet, TEST TESTING

**National Transfer - Përmbledhje**

logarise  
1110188909000187, TEST TESTING

Perfituesit  
1140123027000170, Filan Fisteku, Procredit Kosovo

Adresa  
Prishtine

Arsye  
test


Transferit

|               |                  |
|---------------|------------------|
| Shume         | 10,00 EUR        |
| Fee           | 0,00 EUR         |
| <b>Totale</b> | <b>10,00 EUR</b> |


Regjistroni

## 6. Menyja “Pagesa për aprovim”


Kjo meny përdoret në rastet kur njëri prej përdoruesve i cili ka kontratë të biznesit me atributin “selektiv” ka regjistruar një pagesë dhe ajo duhet të aprovohet prej përdoruesit tjetër të asaj kontrate. Për të aprovuar pagesën e regjistruar më parë, duhet të shtypni mbi fushën “Pagesa për aprovim”.




Automatikisht do të shfaqet pagesa e cila është duke pritur për t'u aprovuar:



Ju duhet të shtypni mbi detajet e pagesës dhe të drejtoheni te pagesa, ku duhet të shënohet numri i gjeneruar në token dhe të shtypet fusha “Aprovo”.




Pas së cilës paraqitet dritarja me përmbledhjen e transferit, e cila konfirmon realizimin e transaksionit.





## 7. Menyja “ 100 urdhrat e fundit”

Menyja “100 urdhrat e fundit” ju mundëson të shihen 100 transferet e fundit të realizuara përmes e-Banking.



The screenshot displays the ProCredit Bank e-Banking interface. At the top, there is a menu bar with 'File', 'Edit', 'View', 'Favorites', 'Tools', and 'Help'. Below this is the ProCredit Bank logo and the text 'Mire se erdhët, Mobile Test'. The main content area is titled '100 urdher pagesat e fundit' and contains a list of transactions. Each transaction entry includes a date, account number, beneficiary name, and amount. Below the list, there are several menu items with right-pointing arrows: 'Llogaritë rrjedhëse', 'Llogaritë e kursimit', 'Llogaritë e kartelave', 'Llogaritë e depozitave afatgjatë', 'Transferet', and 'Pagesa për aprovim'.

| Date       | Account Number              | Beneficiary Name             | Amount           |
|------------|-----------------------------|------------------------------|------------------|
| 2012-12-10 | Llogaritë: 1123003366000118 | Perfituesit: Fani Foleku     | Shuma: EUR 20.00 |
| 2012-11-27 | Llogaritë: 1123003366000118 | Perfituesit: NTP Roja        | Shuma: EUR 40.00 |
| 2012-11-27 | Llogaritë: 1123003366000118 | Perfituesit: NTP Roja        | Shuma: EUR 30.00 |
| 2012-11-27 | Llogaritë: 1123003366000118 | Perfituesit: Agona Nevkadi E | Shuma: EUR 25.00 |

- Llogaritë rrjedhëse
- Llogaritë e kursimit
- Llogaritë e kartelave
- Llogaritë e depozitave afatgjatë
- Transferet
- Pagesa për aprovim